



PROCESVERBAL
Nga mbledhja e I-rë për vitin 2011, e Kuvendit Komunal në
Vushtrri, mbajtur më 27.01.2011

Mbledhja u mbajt në sallën e Kuvendit Komunal duke filluar në orën **10:10**.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe: drejtorët e drejtorive komunale, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të ICO (Zyra Civile Ndërkombëtare), dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit, i cili konstatoi se ka shumicë për punë.

Ferit Idrizi- propozoi që pika nr. 8 të rendit të ditës t'i ndërrohet renditja, dhe të vendoset si pikë e dytë e rendit të ditës. Gjithashtu, propozoj që të futet në "të ndryshme" kërkesa nga Xhavit Hyseni, për ndihmë financiare për sigurim të terapisë.

Sami Istrefi- në emër të grupit parlamentar të PDK-së kërkoj që të hiqen pikat 6 dhe 7 nga rendi i ditës, pasi që në bazë të Ligjit mbi dhënien e pronave në shfrytëzim dhe këmbim, nenit 7, ku i kërkohet kuvendit të themelon një komision të posaçëm në përbërje të përfaqësuesve të ekzekutivit të komunës dhe kuvendit të komunës, që do t'i vlerësonin ofertat dhe do t'ia propozonte kuvendit listën e ngushtë, dhe pasi që mungon një propozim-vendim i tillë, kemi kërkuar që të hiqen pikat e rendit të ditës në fjalë, me qëllim që ky material të vjen i plotë në mbledhjen e ardhshme të kuvendit.

Qazim Azemi- në emër të grupit parlamentar të AAK-së kërkoj që pika nr. 3 e rendit të ditës të mos jetë "Informatë" , por të bëhet ashtu siç parashikohet edhe në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe me Statutin e Komunës, pra të bëhet "Raport". Gjithashtu e mbështeti propozimin e S.Istrefit lidhur me heqjen e pikave 6 dhe 7 të rendit të ditës, duke kërkuar që të bëhet një elaborat më i thuktë. Kurse për pikën nr. 8 të rendit të ditës, kërkoj të shqyrtohet mirë, pasi kështu është shumë e ngarkuar në formën qysh është tani. Në vazhdim paraqiti një kërkesë për urën mbi Sitnicë, pasi që ura i ka tri probleme: ura në të dy anët i ka parrmakët e prishur dhe të dëmtuar, që paraqet rrezik për kalimtarët, në veçanti për fëmijët dhe nxënësit,

prandaj na duhet t'ia bëjmë një kërkesë urgjente Ministrisë së Transportit që ta sanojë këtë urë. Kurse dy problemet tjera janë të komunës: ura po mbushet me dhë, dhe me mbeturina, prandaj kërkoj që inspeksioni dhe komuna ta ndalojnë rreptësisht mbushjen e tillë të urës në fjalë, pasi që kjo gjendje paraqet rrezik për ndonjë fatkeqësi natyrore.

Refik Ramaj- Grupi parlamentar i LDK-së ka dy propozime: pika nr. 3 të hiqet, dhe të përgatitet për mbledhjen e ardhshme si raport; gjithashtu propozoj që të hiqet nga rendi i ditës edhe pika nr. 8, sepse komuna edhe në bazë të planit strategjik është deklaruar dhe kështu duhet të jetë se do të krijoj ambient të favorshëm ndërmarrës, dhe lehtësira, poashtu edhe tërheqje të zhvillimit dhe krijimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, dhe të zhvillimit të tyre, kurse njëra prej këtyre politikave është politika lokale fiskale, e që Grupi parlamentar i LDK-së mendon që nuk duhet të shkohet me rritjen e tarifave dhe të gjobave, por të mbeten ashtu siç kanë qenë. Në fund tha se edhe më herët kemi kërkuar që të spastrohet në një rregullore të vetme, dhe ta kemi si një tekst të vetëm, i cili do të kalonte formalisht përmes asamblesë.

Pajazit Pllana- pasi që subjekti politik LDD është bashkuar me subjektin politik të LDK-së, njoftoj se që nga kjo seancë është pjesë e grupit parlamentar të LDK-së.

Islam Krasniqi- kërkoj që në seancën e ardhshme të kuvendit të futet në rend dite kërkesa për dhënie në shfrytëzim të pronave publike për shfrytëzimin e ndërtimit të xhamive në Lumëmadh, Pestovë dhe Dobërlukë.

Qamil Sahiti- tha se shumë hapësira të komunës nuk menaxhohen nga askush, duke qenë në mëshirën e kohës, ose janë duke u keqpërdorur. Në vazhdim tha se gjendja e stadiumeve në fjalë është e mjerueshme, dhe shtoi se nuk mund të formojmë komision, nëse nuk merret vendimi, pra na e kemi propozuar në kuvend vetëm që të merret vendimi për t'u shpallur tenderi, prandaj kërkoj që të merret vendimi vetëm që të shpallet tenderi.

Muharrem Shabani- lidhur me pikat 6 dhe 7, tha se pajtohet me peshën dhe rëndësinë e tyre, por nuk pajtohet që me çdo kusht të shkohet duke i shkelur procedurat dhe ligjet ekzistuese, ose duke mos e zbatuar formën e duhur për dhënien e këtyre pronave. Pastaj, tha se janë dy objekte kapitale për të tashmen dhe të ardhmen e qytetit, pasi që hapësira publike kemi shumë pak në komunë, e veçanërisht të lëmisë së sportit. Në vazhdim tha se është e arsyeshme që këto dy pika të hiqen nga rendi i ditës, pasi që në bazë të një propozimi të tillë, nuk dijmë çka po dëshirojmë, pasi nuk kemi kurrfarë plani, apo projekt ideor konkret, rreth kësaj çështje, prandaj së pari duhet të shpallet një tender për përgatitjen e një projekti ideor, apo një maketë të thjeshtë se si do të duken stadiumet.

Sami Istrefi- tha se askush nuk është kundër që objektet (hapësirat) në fjalë të futen nën ombrellën institucionale, por paraprakisht duhet të formohet një komision nga kuvendi, dhe të hartohet një projekt-plan, dhe të kompletohet me të gjitha komponentet që i theksuan edhe parafolësit. Kurse lidhur me kërkesën e I.Krasniqit, sqaroi se është diskutuar edhe në KPF dhënia në shfrytëzim e pronës së komunës për ndërtimin e xhamive në fjalë, por kemi kërkuar që të respektohen procedurat ligjore.

Besim Jashari- tha se shkresën që ua ka dërguar kryesuesi i kuvendit anëtarëve të kuvendit, nga mbledhja e KPF-së, thuhet se janë shqyrtuar edhe pikat 6 dhe 7, që u propozuan të hiqen, kurse në fund të shkresës thuhet se materialet në fjalë ju dërgohen me rekomandim që të shqyrtohen dhe aprovohen në mbledhjen e radhës së Kuvendit. Prandaj, shtoi se përfaqësuesit e partive politike janë në KPF, kurse anëtari i KPF-së kërkon që pikat në fjalë të hiqen, dhe kjo flet për joseriozitetin e tij.

Ferit Idrizi- ripropozoj që pika 6 dhe 7 të hiqen nga rendi i ditës. Gjithashtu të hiqet pika 3 e rendit të ditës, dhe të vjen në seancën e shkurtit si raport. Pika 8 e rendit të ditës të futet e dyta e radhë, kurse në "të ndryshme" të futet kërkesa e Xhavit Hysenit për ndihmë.

Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, Kuvendi me 27 vota “për”, 8 “kundër” aprovoi këtë:

Hiqen pikat 3, 6 dhe 7 të rendit të ditës, pastaj pika 8 e rendit të ditës, radhitet si pikë e dytë për diskutim, kurse shtohet në “të ndryshme” kërkesa për ndihmë nga Xhavit Hyseni.

R E N D I T E

- 1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e fundit e KK-së, dt. 30.12.2010.**
- 2. Shqyrtimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale.**
- 3. Shqyrtimi i Propozim- Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2011.**
- 4. Shqyrtimi i parë i Draft-Rregullores mbi përcaktimin e kriterëve të ndarjes së mjeteve financiare nga fondi për transfere dhe subvencione për etnitetet publike dhe jo publike të Komunës.**
- 5. Shqyrtimi i dytë i Draft-Rregullores për organizimin e punës dhe mësimin në shkollat e mesme të larta të Komunës së Vushtrrisë.**
- 6. Eventuale:**
 - a. Kërkesë për ndihmë nga Xhavit Hyseni.**
 - b. Pyetjet eventuale të anëtarëve të kuvendit.**

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e fundit e KK-së, dt. 30.12.2010.

Ismet Gashi- paraqiti vërejtje lidhur me formën e paraqitjes së marrjes së vendimeve në procesverbal, duke përmenduar si shembull pikën nr. 5 të rendit të ditës, dhe shtoi se i ka dhënë disa propozime, por kanë dhënë edhe të tjerët, mirëpo nga procesverbali nuk mund të kuptohet cilat nga këto propozime janë pranuar, e cilat janë refuzuar. Kurse te pika nr. 8 është dashtë të ceket, pasi që e ka potencuar se si grup parlamentar e përkrahin si propozim-vendim, mirëpo hartuesit të konsultohen me Ligjin mbi dhënien në shfrytëzim të tokës, se a është konform atij ligji, kurse në procesverbal është paraqitur i miratuar pa kurrfarë vërejtje.

Sabit Kadriu- në faqe nr. 3, gjatë diskutimit tim, ndër të tjera është shkruar: “mandej tha se duhet me ia bërë me dije AKP-së...”, kurse duhet të jetë “duhet t’ia bëjmë me dije AKP-së...”. Kurse në faqen nr.8, nuk është përfunduar në tërësi, prandaj në fjalinë “...renovimi i shtëpisë së Mahmut Agë Gjinollit nuk i plotëson kushtet për të qenë bibliotekë”, duhet shtuar këtë fjali: “e as muze dhe arkiv”.

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:

Aprovohet procesverbali i mbledhjes së fundit të Kuvendit të Komunës, me vërejtjen e paraqitur nga: I. Gashi dhe S. Kadriu.

2. Shqyrtimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale.

Isuf Jashari- paraqiti sqarimet hyrëse.

Zeqir Hasani- tha se në parim është kundër rritjes së taksave në nivel lokal, të bizneseve që afarojnë në komunën tonë, duke pasë parasysh zhvillimin ekonomik në rënie, që këtë mos-zhvillim ekonomik e mundëson mungesa e madhe e energjisë elektrike, mungesa e ujit, klima e pavaforshme për zhvillimin e tyre, si dhe Ligji i prokurimit, i cili është më destimulativ në Evropë, si dhe duke u bazuar në faktin se sektori privat është shtyllë e zhvillimit ekonomik dhe punësimit, ku në këtë sektor gjenerojnë afër 80 % të të punësuarëve në komunën tonë, shtoi se një rritje e tillë prej 25 deri në 120 % është jo e drejtë, në kohën kur po ballafaqohemi me një krizë ekonomike globale, duke shtuar se kjo ngritje e taksave do të ndikon direkt në humbjen e vendeve të punës, kurse bazë e zhvillimit ekonomik dhe parim kryesor i qeverisjes lokale është krijimi i vendeve të reja të punës. Gjithashu, tha se më lehtë do të mbushej buxheti duke inkasuar të gjitha ngarkesat nëpër biznese, pasi që rreth 35 % e ngarkesave figurojnë të painkasuara, se sa duke i tkurr bizneset me ngritjen e taksave ndaj tyre. Poashtu kërkoi që kur kemi raste të tilla të ngritjes apo dëmtimi të interesave të biznesit, të kemi edhe përfaqësues të biznesit prezent në seancë të kuvendit, dhe për këtë arsye ka kërkuar që të formohet një shoqatë e afaristëve, në mënyrë që edhe komuniteti i biznesit ketë përfaqësues në mbledhjet e kuvendit komunal, sidomos kur merren vendime që prekin interesat e tyre.

Sami Istrefi- tha se në vitin 2009 Kuvendi i Komunës ka marrë një vendim, me ç'rast të gjitha kategoritë e bizneseve janë liruar 40 % për shkak të krizës ekonomike globale. Pastaj propozimet që i ka propozuar komisioni përkatës për rritje të tarifave tek bizneset, tha se të gjitha komunat kanë tarifa më të mëdhaja, se sa ne, por paraprakisht komisioni përkatës, ose Drejtoria e Ekonomisë duhet ta përgatis një informatë për gjendjen e biznesit në komunën tonë, pasi që kuvendit do t'i lehtësohet puna për të marrë vendime të arsyeshme, sepse nuk dihet sa biznese të vogla po mbyllen, sa janë në proces të mbylljes, prandaj kur të vjen në kuvend për miratim final, është mirë ta kemi një informatë mbi gjendjen e biznesit në komunën tonë.

Refik Ramaj- tha se nuk e kemi para vetes një analizë të qartë pse vijmë deri te këto ndryshime, dhe shtoi se ka edhe ndërrime që janë pak të qëlluara, siç janë “bankat, ekspoziturat”. Gjithashtu i mungon lekturimi, dhe ka mangësi në përpilimin e fjalive, duke shtuar se duhet thënë “ekspoziturat e bankave”. Pastaj paragrafi 1.29 (b), do të duhej të jetë: “barnatoret dhe shërbimet veterinarë”, dhe shtoi se është absurd që barnatoret veterinarë ngarkohen me 300 €, kurse barnatoret shëndetësore me 250 €. Në vazhdim tha se te rritja e taksave, duhe të jetë një politikë e qartë e komunës, se cili është qëllimi i saj, çka duhet të stimuloj dhe çka duhet të destimuloj. Mandej lidhur me paragrafin 3.1, tha se nuk ka informacion që ka ordinanca të përgjithshme, pasi që të gjitha janë të specializuara për një lëmi të ngushtë. Pastaj, lidhur me paragrafin 3.4, tha se në vend të stimulohet auditimi, në këtë rast po destimulohet. Ndërsa, duke iu referuar paragrafit 4.7, tha se ligji nuk njeh termin “subjekt pasiv”, dhe shtoi se kjo dukuri është zhdukur, pasi që me riregjistrimin e kompanive, numrave të regjistrimit dhe numrave fiskal, dhe ky ka qenë qëllimi që bizneset që nuk funksionojnë, të shuhen prej evidencës, dhe në këtë fillim të vitit nuk kemi biznese pasive, prandaj të lirohen prej taksës në bazë të vërtetimit që marrin, është e palogjikshme, pasi që ligji nuk njeh termin “subjekt pasiv”. Në fund tha se qëndrimi i Grupit parlamentar të LDK-së është që sjellet një analizë sipas bransheve, sa subjekte janë përfshirë, sa ka qenë ngarkesa, sa janë realizuar, dhe politika e komunës duhet t'i stimulojë zhvillimin e biznesit, të krijoj hapësira të reja për ndërmarrësi të re, duke i ulur taksat, por t'i obligon të gjithë për të paguar taksat, kurse baza të ulet.

Pajazit Pllana- tha se qyteti i Vushtrrisë ka edhe spitalin privat, por nuk figuron askund, që duhet t'i nënshtrohet procedurës së tarifës, taksës dhe tatimit. Pastaj termi “ordinancat e përgjithshme” është i tejkalar, i cili nuk mund të hyjë më në rrjedhat e reja, por ordinancat e përgjithshme ndahen në: ordinanca specialistike të

mjekësisë familjare; ordianca specialistike të mjekësisë së punës, dhe ato që kanë konotacionin që mund të punojnë, të licencohen, dhe mund t'i nënshtrohen procedurës, kurse ordiancat specialistike ndahen në ordianca operative dhe jo operative, pra ordiancat operative duhet t'i nënshtrohen një procedure që kanë punë më të shtrenjtë dhe duhet të paguajnë tatim më shumë, prandaj duhet të bëhet një ndarje, pasi që edhe shtetit do t'i sillnin më tepër të ardhura. Në vazhdim tha se ordianca specialistike prej 120 € është rritur në 200 €, kurse rëntgeni prej 160 € është rritur në 200 €, dhe kjo është absurd, pasi që ai i cili ka një volum pune të madh dhe ka mjete më shumë, paguan më pak. Ndërsa, laboratorët mjekësor duhet t'i nënshtrohen një procedure të klasifikimit, pasi që aty bëhen edhe analiza që janë shumë të shtrenjta, kurse nuk i nënshtrohen tatimit, tarifës dhe taksës.

Besim Jashari- tha se propozim-vendimi në fjalë askund nuk shënon se nga kush ka ardhur, dhe poashtu është dashtë të ceket një arsytim pse po e bën këtë propozim-vendim, për secilën pikë veç e veç.

Ferit Idrizi- propozoj që drejtorja që e ka sjellë propozim-vendimin në fjalë, të sjellë informata dhe analizë për gjendjen e bizneseve në komunën tonë. Poashtu, propozoj që këto propozim ndryshime të rregullores në fjalë të shkojnë në diskutim publik.

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit me 18 vota "për" , të tjerët "abstenim", lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:

a. Ipet në diskutim publik Propozim-vendimi për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale 01 Nr. 742/08 të datës 30.12.2008

b. Diskutimi publik fillon nga data 28.01.2011 dhe zgjatë deri më 18.02.2011.

3. Shqyrtimi i Propozim- Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2011.

Ferit Idrizi- paraqiti sqarimet hyrëse.

Muharrem Shabani- tha se ky plan duhet të përfshijë punën e qeverisë komunale dhe institucioneve ekzekutive të të gjitha lëmive, dhe në tërësi çështjet dhe problematikën e qytetarëve të komunës sonë për një vit, prandaj ky plan është i mangët në shumë lëmi që parashihen në nenin 17 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, e që janë kompetenca ekskluzive të kuvendit, e që nuk janë përfshirë fare në pikat e rendit të ditës gjatë seancave sipas muajve paraprakë në rend dite, pra mungon: zhvillimi ekonomik, planifikimi, shfrytëzimi i tokës, shërbimet komunale, uji, ujërat e zeza, arsimit, çështjet sociale, mirëmbajtja e ambientit publik, bujqësia, shfrytëzimit i hidrosistemit të ujitjes, prandaj është dashtë të trajtohen edhe këto tema.

Sabit Kadriu- tha se në shumë seanca kemi kërkuar që të bëhet instalimi i mjeteve teknike, që puna e kuvendit të jetë më e lehtë, prandaj kërkoi që në planin e punës së kuvendit për sivjet, të përfshihet kjo çështje, në mënyrë që kuvendit të jetë sa më praktik dhe më i lehtë për punë.

Veli Karaça- tha se edhe në KPF ka dhënë kontributin për planin në fjalë, duke dhënë edhe sugjerime me shkrim për të bërë disa ndryshime, por nuk janë përfshirë në këtë plan. Pastaj shtoi se plani i kuvendit duhet të jetë udhërrëfyes, apo bazë për planet tjera të organeve komunale, tha se në këtë plan nuk janë përfshirë shumë pjesë të përgjegjësive që i ka kuvendi komunal. Për nga forma plani në fjalë i përmbushë standardet, por për nga përmbajtja, duke filluar prej qëllimit, i cili nuk precizon një rezultat përfundimtar që ne synojmë ta arrijmë. Mandej, objektivat që duhet të jenë udhërrëfyes për punën tonë dhe deklaratimet për rezultate specifike, që ne synojmë t'i arrijmë, e që duhet të përfshihen të gjitha çështjet që ne dëshirojmë t'i ndryshojmë, pra objektiva që do të paraqiteshin pas një analize të gjendjes, apo të një raportit gjithëpërfshirës që do t'i vlerësonte të gjitha ngecjet, dështimet dhe mundësitë për të ndryshuar diçka për të mirë, dhe në këtë mënyrë përmes këtyre objektivave do të mund ta monitoronim punën tonë dhe të organeve komunale, se a

janë duke shkuar këto aktivitete në rrugën e duhur. Mandej, tha mungojnë shumë çështje të rëndësishme që nuk janë përfshirë në këtë plan, e që janë: shërbimet, përgjegjësitë e komunës, arsimi, shëndetësia, transparenca, informimi i qytetarëve, menaxhimi i pronës, taksat. Pastaj tërë këto objektiva do të duhej të zërtheheshin në aktivitete, duke shtuar se ky plan ka nevojë që të jetë shumë me detaj dhe të rishikohet edhe një herë. Në vazhdim lidhur me aktivitetet e muajit mars, nën “c”, propozoi që në vend të fjalës “nënave”, të thuhet “gruas”. Gjithashtu lidhur me shqyrtimin e draft-rregullores për ndarje të mirënjohjeve, kërkoi që shqyrtimi i parë të bëhet në muajin mars, kurse shqyrtimi i dytë në muajin prill, në mënyrë që Ditën e Çlirimit, para seancës së qershorit, ta kemi të aprovuar rregulloren në fjalë.

Qazim Azemi- paraqiti disa propozime që të përfshihen në planin e punës së kuvendit: te “parathënia” propozoi që t’i shtohet “kuvendi i komunës është organ mbikëqyrës”. Pastaj te “objektivat”, lidhur me raportet e punës së kryetarit të komunës, propozoi që të kemi raporte 3-mujore, në muajt: prill, korrik, dhjetor, kurse raporti për tërë vitin, bëhet në muajin e parë të vitit të ri. Gjithashtu, propozoi që në planin e punës në fjalë, para muajit prill, të parashihet ndonjë aktivitet (ose informatë) lidhur me regjistrimin e popullsisë. Mandej, propozoi që në këtë plan të punës të parashikohet që me iniciativën e njësitit të Këshillit për të Drejtat e Njeriut ose vet kuvendi të inicon mbledhjen e fakteve dhe të ngritet akuzë për ata që na kanë vrarë, prerë dhe djegur me qindra e mijëra vite.

Sami Istrefi- tha se Grupi parlamentar i PDK-së i mbështet të gjitha sugjerimet e parafolësve, që vërtet ky propozim-plan i punës së kuvendit të jetë sa më gjithëpërfshirës, duke shprehur mendimin që plani i punës në fjalë në vija të trasha është i trajtuar shumë mirë. Pastaj tha se plani i punës në fjalë përmban një paragraf shumë të rëndësishëm që është “trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për kuvend”. Në fund mbështeti edhe propozimin për formim të komisionit për regjistrimin e popullsisë dhe propozimin për ngritjen e çështjes për dëmet në njerëz dhe dëmet materiale, që pushteti serb ia ka shkaktuar popullit të Kosovës.

Besim Jashari- tha se plani i punës në fjalë nuk ka një planifikim të balancuar të punës së kuvendit, pasi që ka seanca ku parashikohen pak pika të rendit të ditës, e që nuk kanë ndonjë peshë të rëndësishme, kurse në disa seanca parashikohen shumë pika të rendit të ditës, dhe të njëjtat pika janë shumë të rëndësishme, dhe nga kjo del se rendi i ditës është shumë i ngarkuar, duke pamundësuar shqyrtimin serioz të çështjeve serioze dhe meritore. Gjithashtu kërkoi që të rishikohet ky plan i punës, pasi që në muajin shkurt janë planifikuar pika të rendit të ditës jashtëzakonisht të rëndësishme, prandaj kërkoi një balancim të punës, në mënyrë që të mos ketë disa muaj seanca shumë të ngarkuara, kurse në disa muaj të ketë seanca shumë më pak të ngarkuara, duke shtuar se në muajin mars janë planifikuar vetëm dy pika të rendit të ditës.

Ferit Idrizi- tha se propozim-planin i punës nuk është i përkryer, dhe ka nevojë për plotësime dhe sugjerime. Pastaj tha se plani i punës në fjalë i përfshinë ato aktivitete të cilat mund të planifikohen për një vit kalendarik, dhe nuk kemi të drejtë të hyjmë në fushën e ekzekutivit.

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit me 30 vota “për”, 5 “abstenim”, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:

Aprovohet Propozim- Plani i Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2011, duke inkorporuar në të edhe vërejtjet e paraqitura gjatë diskutimit.

4. Shqyrtimi i parë i Draft-Rregullores mbi përcaktimin e kritereve të ndarjes së mjeteve financiare nga fondi për transfere dhe subvencione për etnitetet publike dhe jo publike të Komunës.

Refik Ramaj- tha se draft-rregullorja në fjalë është e mirë dhe rregullon një çështje sensitive, por Grupi parlamentar i LDK-së mendon se mund të korrigohet edhe pak, duke paraqitur propozime dhe vërejtje për këto nene: neni 1.2, ku thuhet "...kryetari i komunës, sipas kërkesave të arsyetuara....", tha se këtu nuk precizohet nga kush, prandaj kërkoi të qartësohet nga kush; neni 2, kërkoi që termi "në të holla" , të zëvendësohet me termin "në të gatshme" ose "në para", pasi që kjo është gjuha zyrtare që përdoret në financa; neni 4, te fjalia "arsyetimi i kërkesës", propozoi që t'i shtohet "arsyetimi i kërkesës me prova të qarta dhe bindëse"; neni 5, tha se fjalia është konfuze, prandaj propozoi të shkruhet "...Drejtori t'i jep mendim profesional për përfituesit, ose për listën për përfituesit. Gjithashtu te fjalia e fundit "Propozimi i dërgohet për aprovim kryetarit të komunës", propozoi që të shtohet edhe kjo fjali "Kryetari aprovon kërkesat e justifikuara dhe të dëshmuara me dokumentacion përcjellës"; neni 7, tha se me rastin e fatkeqësive natyrore nuk mjaftojnë 500 €; neni 9, tha se ky nen bie ndesh me Ligjin mbi Administratën Tatimore të Kosovës, pasi që një nen i atij ligji përcakton se investimet mbi 500 € mund të kapitalizohen, prandaj kërkoi që ky nen të korrigohet; neni 10, propozoi që të hiqet krejt, pasi që te emërtimi i rregullores kuptohet qartë se këto janë të pakthyeshme, pasi që po thuhet se janë ndihma; neni 12, te pjesa e fjalisë "...banorët...", propozoi t'i shtohet "banorë rezidentë"; neni 13.2, tha se nuk ka rrjedhë logjike fjalia, prandaj propozoi të thuhet "Kërkesat e pakompletuara, komisioni nuk do t'i procedoj më tutje"; neni 13.3, tha se nuk përmendet fare roli i kryetarit, duke pyetur se a duhet të ketë këtu një rol edhe kryetari; te neni 14, lidhur me pjesën e fundit fjalisë "personi i caktuar mund të ndihmohet vetëm një herë në vit" , dhe pyeti se çfarë rregullore mund të jetë kjo, që nëse i shfaqet prapë nevoja, ndonjë fatkeqësi një individ dhe ai privohet nga e drejta për ta marrë një shumë simbolike, prandaj propozoi t'i shtohet "me përjashtim të rasteve të jashtëzakonshme"; neni 16, në vend të termit "të jepet", propozoi të thuhet "të kryhet" ose "të alokohet".

Ismet Gashi- lidhur me draft-rregulloren në fjalë paraqiti këto vërejtje: neni 2, tha se është krijuar hapësirë që komisionin mund ta formoj kryetari i komunës, përkatësisht drejtori i DMSHS-së, kurse te neni 13 kompetent për formimin e komisionit është drejtori i DSHMS-së, prandaj kërkoi që të sqarohet dhe të thuhet se këtë komision e formon kryetari i komunës, ose drejtori i DSHMS-së, e jo të dytë njëkohësisht ta kenë atë mandat; neni 7, propozoi t'i shtohet "në raste urgjente"; neni 11, te fjalia "Kategoritë që kanë të drejtë të aplikojnë për ndihmë momentale" , propozoi të ndërrohet dhe të thuhet "Kriteret që duhet të plotësohen për të qenë përfitues i kësaj ndihme" , gjithashtu kërkoi që të bëhen përmirësime teknike të alineve; neni 15, tha se kjo nuk është e mirë fare, prandaj kërkoi që ose t'i mbetet kompetencë vet drejtorit, ose komisioni i vlerëson dhe ia dorëzon listën për miratim kryetarit të komunës, pasi që komisioni nuk do të mund të jetë i pavarur në punën e vet.

Safet Idrizi- në vazhdim paraqiti sqarimet shtesë lidhur me draft-rregulloren në fjalë.

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:

a. Ipet në diskutim publik Draft-rregullorja për përcaktimin e kriterëve të ndarjes së mjeteve financiare nga fondi për transfere dhe subvencione për ndihmë momentale entiteteve publike dhe jo publike.

b. Diskutimi publik fillon nga data 28.01.2011 dhe zgjatë deri më 18.02.2011.

5. Shqyrtimi i dytë i Draft-Rregullores për organizimin e punës dhe mësimin në shkollat e mesme të larta të Komunës së Vushtrrisë.

Bahrije Pllana- lidhur me draft-rregulloren në fjalë, tha se në nenin 17 mungojnë detyrat e këshillit të shkollës dhe të këshillit të nxënësve, prandaj duhet të

përfshihen edhe detyrat e këtyre dy organeve qeverisëse, që janë një opozitë konstruktive për drejtorin e shkollës..

Ismet Gashi- tha se neni 4.1 dhe neni 11.1 nuk përputhen, dhe shtoi se neni 1 i këtij udhëzimi administrativ ka për qëllim të përcaktoj masat ndëshkuese që do të merren ndaj atyre prindërve, fëmijët e të cilëve për arsye të ndryshme nuk e regjistrojnë apo e ndërprejnë shkollimin e detyruar.

Sabit Kadriu- tha se në shkolla të mesme kemi dy ekstreme: mbulesën, që vjen në kundërshtim me Ligjin e Arsimit nëpër shkollat laike, kurse ekstremi tjetër është se vajzat dalin të përdalura, prandaj shtoi se do të duhej ta rregullonte ligji çështjen e nxënësve me mbulesa, e në bazë të ligjit edhe rregullorja në fjalë, e cila fare nuk e ka trajtuar këtë problem. Prandaj është mirë që të trajtohet ky problem, dhe në këtë rregullore të definohet se si duhet ne të veprojmë në këto raste, duke shtuar se nëse ne nuk e përfillim ligjin, kjo do të shndërrohet në dukuri.

Vlora Qirezi- tha se në shqyrtimin e parë të draft-rregullores në fjalë, grupi parlamentar i LDK-së ka potencuar se nuk është në rregull që marrja e vërtetimit nga ana e nxënësve të bëhet me pagesë në vlerë prej 1€. Poashtu, kemi propozuar që të cekem procedurat për inicimin e përgjegjësive dhe shqyrtimin e masave disiplinore për nxënës, mirëpo përveç dispozitave kalimtare në këtë rregullore (që ka qenë propozim i grupit parlamentar të LDK-së), propozimet tjera që janë aprovuar në kuvend nuk janë inkorporuar.

Ferit Idrizi- kërkoi që të kthehet përsëri në seancën e radhës, pasi që edhe mungojnë përfaqësuesit nga Drejtoria e Arsimit. Gjithashtu kërkoi që të inkorporohen vërejtjet e diskutuesve, dhe kërkoi të hiqet pagesa nga ana e nxënësve për marrjen e vërtetimit. Kurse te neni 10, kërkoi që të hiqen “obligimet e prindit”, pasi që të njëjtat janë në nenin 11.

Besim Jashari- paraqiti vërejtje për mungesën e drejtorit të arsimit, dhe shtoi se mungon edhe ndonjë përfaqësues nga drejtoria në fjalë. Poashtu mungon një akt përcjellës, që do të na njoftonte që ka qenë në diskutim publik, dhe çka është nxjerr nga ai diskutim publik. Pastaj tha se për hartimin e rregullores do të duhej të përfshihej edhe Komiteti Konsultativ për Arsim.

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:

Nuk aprovohet me arsyetimin se nuk ka qenë prezent Drejtori i Arsimit, apo ndonjë përfaqësues nga drejtoria në fjalë, gjatë diskutimit të kësaj Draft-rregulloreje në seancën e kuvendit.

Gjithashtu është kërkuar nga Drejtoria e Arsimit që t'i bashkëngjitet një akt përcjellës që do të njoftonte ecurinë e diskutimit publik për Draft-rregulloren në fjalë, si dhe me rastin e hartimit të kësaj Draft-rregulloreje të konsultohet edhe Komiteti Konsultativ për Arsim.

6. Eventuale:

a. Kërkesë për ndihmë nga Xhavit Hyseni.

Pajazit Pllana- tha se është një kërkesë që është në pyetje jeta e njeriut, një të riu që ka një sëmundje shumë të rëndë, kërkoi që rastit në fjalë t'i ndihmohet, pasi që kemi obligim human, duke propozuar që t'ia dhurojmë maksimumin e ndihmës, pasi që është një terapi shumë e shtrenjtë.

Sami Istrefi- tha se duhet të vlerësohet lartë puna e kryetarit të komunës, pasi që i ka ndihmuar në forma të ndryshme Xh. Hysenit, duke e dërguar edhe në shtetin turk, dhe është trajtuar në mënyrën më të mirë, pa asnjë shpenzim. Pastaj në emër të grupit parlamentar të PDK-së e mbështeti kërkesën në fjalë për t'ia dalur në ndihmë për t'ia mundësuar blerjen e terapisë së nevojshme dhe të domosdoshme.

Qazim Azemi- grupi parlamentar i AAK-së e mbështet kërkesën që të ndihmohet punëtori në fjalë.

Ferit Idrizi- propozoi që t'i ndihmohet me shumën prej 5.000 €.

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:

Aprovohet kërkesa e Xhavit Hysenit nga Vushtrria, punëtor i Administratës së komunës, për ndihmë financiare për sigurim – blerje të terapisë mjekësore për shërim nga sëmundja e tumorit malinj, duke lejuar mjete financiare në shumë prej 5.000.00 € (pesëmijë euro).

Pagesa e mjeteve të cekura si në pikën paraprake duhet të bëhet nga mjetet e buxhetit të komunës – fondi për transfere dhe subvencione.

b. Pyetjet eventuale të anëtarëve të kuvendit.

Refik Ramaj- kërkoi informatë për masat e ndërmarra për pastërtinë e qytetit të Vushtrrisë. Pastaj kërkoi nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa që ta përgatit një doracak të procedurave dhe politikave financiare, pasi që Komunës i mungon një i tillë, e që do të duhej ta kishte. Në fund kërkoi nga komuna listën e inventarizimit të pasurisë së Komunës.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00.

Procesmbajtësi:
Albanez Tahiraj

Kryesuesi i Kuvendit
Ferit Idrizi